

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Emili Holidays" SH.P.K.

Në Tiranë, sot më datë **25 Qershor 2018 (dymijë e tetëmbëdhjete)**, unë i nënshkruari, **Jakup Xhelili**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.01.1942, lindur në Prizeren dhe banues në Borsh-Himare, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me **nr.025152241** me cilësinë e "ortakut themelues", deklaroj se me vullnet të lirë të plotë e të sinqertë e të pavesuar, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", (i ndryshuar), ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, " Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", (i ndryshuar), hartoj statutin e shoqërisë "**Emili Holiday**" SH.P.K.

KREU I
EMËRTIMI - SELIA - OBJEKTI - KOHËZGJATJA

Neni 1-Emërtimi

1.1 Shoqëria është krijuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është "**Emili Holidays**" Sh.p.k (në vijim e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria do të fitoj personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

1.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, legjislacionin shqiptar në fuqi, me këtë Statut.

1.3 Shoqëria "**Emili Holidays**", është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "*ortaku i vetëm themelues*" z.*Jakup Xhelili*, e cila nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 2-Selia

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Plazhit, Borsh, pasuria nr.268/3 zk.1253, Bashkia Himare.**

2.2 Shoqëria mund të krijoj degë, zyra, filiale dhe të zhvilloj aktivitet në vënde të tjera, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të ortakut të Shoqërisë.

Neni 3-Objekti i Shoqërisë

3.1 Shoqëria ka për objekt dhe qëllim të saj aktivitetet tregtare në fushën e turizimit si:

- Shërbime hotelerie, qera të objekteve me destinacion kryerjen e shërbimeve të ndryshme, dhenie me qera të ambjenteve për akomodimin e turistëve të huaj dhe vendas, si dhe çdo aktivitet tjetër të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të kryejë operacione tregtare me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme,



3.3 Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Neni 4-Kohëzgjatja

4.1 Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të ortakut të vetëm dhe/ose të asamblesë së ortakëve në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislationin në fuqi.

KREU II KAPITALI

Neni 5 -Kapitali

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10'000 Lekë (dhjetemije Lekë). Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga "ortaku i vetëm" i shoqërisë dhe përbet nga 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 10'000 Lekë (dhjetemije Lekë), që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.2 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

5.3 Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

5.4 Kapitali i Shoqërisë apo çdo kontribut në para për zmadhimin e kapitalit paguhet në llogarinë bankare të Shoqërisë.

5.5 Kuotat janë të transferueshme sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin Tregtar, në këtë Statut.

Neni 6- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

6.2 Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe/ose të asamblesë së ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

KREU III ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

Neni 7-Organi Vendimmarrës

7.1 Organet drejtuese të shoqërisë, referuar dispozitave të ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" janë:

- Asambleja e ortakëve.
- Administratori i shoqërisë.

7.2 Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

7.3 Ortaku i Vetëm, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;



- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 7.4 Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 7.5 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8 - Administrimi

8.1 Administrator i shoqërisë është **Gerond Labi**, i biri i Arjanit, shtetas shqiptar, i datëlindjes 16.09.1999, lindur dhe banues në Tirane, përcaktuar dhe vendosur nga "ortaku i vetëm themelues" i shoqërisë Z.Jakup Xhelili.

Administratori mund të emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë dhe/ose të Asamblesë së ortakëve.

Neni 9 - Dispozita përfundimtare

9.1 Ky Statut u redaktua në gjuhën shqipe ne tre kopje dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë e të plotë e të pavesuar nga ortakut themelues.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

"Emili Holidays" Sh.p.k

Jakup XHELILI

